



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:054781

Datë: 25.06.2019

Numri i dokumentit: 00375762

DKR P nr.101/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË –DEPARTAMENTI PËR KRIME TE RENDA, në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtarja: Lumturije Muhaxheri- Kryetare e Trupit Gjykues, Gjyqtarëve, Sali Berisha dhe Ahmet Rexhaj -anëtar të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shpresa Kërnja, në çështjen penale kundër të akuzuarve: D. M. , për shkak të veprës penale vrasje e mbetur në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, si dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, të akuzuarit A. I. dhe F. K., për shkak të veprës penale si bashkëkryes lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Peje –Departamenti për Krime te Renda, PP/I nr.88/18 të dt.30.11.2018, pas mbajtjes së seancës fillestare dt.15.01.2019, seancës së dytë të mbajtur me dt.26.02.2019, dhe seancave të shqyrtimeve gjyqësore, publike, të mbajtura me dt.17.04.2019 e gjere me dt 14.05.2019, në praninë e Prokurorit te Shtetit – Agron Galani , të akuzuarit D. M. dhe mbrojtësit te tij av Gëzim Kollqaku nga Peja, sipas autorizimi, të akuzuarve A. I. dhe F. K., përfaqësuesit të zyrës për mbrojtjen e viktimave D. H. , te dëmtuarit A2 B. , me dt.17.05.2019, mur dhe me dt,14.06.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër te akuzuarve:

1. D.M., i njohur sipas nofkës “M...”, lindur me ..., në Pejë, i biri i H. dhe nënës S., e gjinisë J., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i martuar babë i tre fëmijëve, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

2. A. I., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit, i lindur me ..., në Pejë, i biri i A. dhe nënës S. e gjinisë B., ka të kryera shkollën e mesme, i martuar babë i dy fëmijëve, me profesion agjent doganor Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

3. F. K., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit ..., i lindur me ..., në Pejë, i biri i A. dhe nënës A. e gjinisë K., ka të kryera shkollën e mesme, i martuar babë i dy fëmijëve, i pa punë, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

I PJESA GJYKUESE

I Akuzuari D.M.

ESHTË FAJTOR

Për shkak se:

1.Me dt.11.09.2018, rreth orës 22.17 minuta, në rrugën “...” në Pejë, në afërsi të kafiterisë “T...”, për shkak të mosmarrëveshjeve në mes të pandehurit D., dhe të dëmtuarit A2, me dashje ka tentuar ta privoj nga jeta të dëmtuarin A2 B., në atë mënyrë pasi që i dëmtuari A2, gjersa ishin brenda kafiterisë “T...”, papritmas me grushte e godet të akuzuarin D., në pjesën e nofullës së djathë dhe me vrap fillon të largohet nga lokali, pas tij vrapon i akuzuari A. dhe D. i cili ka bërë titur me zë të lartë “ndal, kush je”, mirëpo A2i vazhdon të vrapoj dhe në atë moment i akuzuari D., nga çanta e tij të cilën e mbante në krah ka nxjerr pistoletën e tij “SigSauer” model ... mm, duke shtënë dy herë në drejtim të A2it, me ç’rast me një predhë e godet në pjesën e sipërme të kokës me hyrje – dalje transkutane, në për lëkurën në anenë djathtë të kokës dhe pasi i dëmtuari A2 vrapon edhe disa metra dhe rrëzohet para dyqanit “F..”, atij i afrohet i akuzuari D., i cili e godet edhe dy herë me qyqë të pistoletës në pjesën e epërme të kokës, e pastaj largohet nga vendi i ngjarjes, gjersa i dëmtuari dërgohet në Spitalin Regjional në Pejë,

me çka ka kryer veprë penale të vrasjes së mbetur në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

2.Më parë ka siguruar dhe gjerë me dt.11.09.2018, pa autorizimi ka poseduar një pistoletë të llojit “SigSauer” model .. cal.9x19, së bashku me një karikator dhe 8 fishek, të të njëjtit kalibër, e me të cilën pistoletë ditën kritike ka shtënë dy herë në drejtim të dëmtuarit A2 B.j, e të cilën armë pastaj i akuzuari me dt.17.09.2018, ju ka dorëzuar hetuesve policor,

Me çka ka kryer veprë penale të mbajtjes në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke u bazuar në nenin 41, 45, 46, 62 par.1 dhe 2 pika 2.7, 69, 73, 75 par.1 pika 1.2, 83, nenit 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, nenit 365, 366, 450, 463 par.2, të KPRK, të akuzuarin D. M., e

GJYKON

Për veprën penale nga neni 178 lidhur me nenin 28 te KPRK-se me dënim burgu në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) muajve, ne të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.17.09.2018, e gjerë me dt.21.01.2019.

Për veprën penale nga neni 374 par.1 te KPRK-se e gjykon me dënim me gjobe ne shume prej 500 € (pesëqindtë) euro, të cilën shumë është i detyruar ta paguajë në afat prej 90 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast të mos pagimit të dënimit me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje, prej(njëzetepesë) 25 ditësh, ashtu që çdo 20 € (njëzet) euro, të dënimit me gjobë, i përcakton një ditë burg.

Ndaj të akuzuarit shqiptohet dënimi plotësues konfiskimi i pistoletës “SigSauer” model...cal.9x19 mm, dhe urdhërohet shkatërrimi i saj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit numri i rastit ne polici 2018-DA-1851.

I akuzuari obligohet në pagimin e shpenzimeve të procedues penale shumë prej 50 € (pesëdhjetë) euro si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 € (pesëdhjetë) euro, kurse në emër të taksës së programit për kompensimin e viktimave obligohet të paguaj shumë prej 50 € (pesëdhjetë) euro, te gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar A2 B., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

II PJESA LIRUESE

Të akuzuarit A. I. dhe F. K.

Komfor nenit 364 par.1 pika 1.3

LIROHEN NGA AKTAKUZA

Gjëja se:

Me dt.11.09.2019, rreth orës 22.17 minuta, në rrugën “...”, në Pejë, mu para dyqanit “F...”, e pasi që i dëmtuari A2 B.j, rrëzohet, të akuzuarit A. dhe F., e godasin të njëjtin dy herë me grushta në pjesë të ndryshme të trupit, duke i shkakuar lëndim të lehtë trupor, gjersa i akuzuari D., e godet të dëmtuarin dy herë me qykë të pistoletës në pjesën e sipërme të kokës e pastaj largohen nga vendi i ngjarjes,

Me çka në bashkëkryerje kishin për të kryer veprë penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore - Departamenti për Krime te Renda ne Pejë, ka ngrit aktakuzë PP/I nr.88/18 të dt.30.11.2018, kundër të akuzuarve: D. M., për shkak të veprës penale vrasje e mbetur në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, si dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, të akuzuarit A. I. dhe F. K. qe te dy nga Peja , për shkak të veprës penale si bashkë kryes lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit te Shtetit PP/I nr.88/18 të dt.30.11.2018, në seancën e shqyrtimit fillestar, Gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 246 par.4 të KPPK-se, të akuzuarve ju ka ofruar mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mospranimin e fajësisë. Me këtë rast i akuzuari D. M. ka pranuar fajësinë për veprën penale të vrasjes e mbetur në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedimit paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, te

akuzuarit A. dhe F. nuk e pranuan fajësinë për veprë penale si bashkë kryes lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ne raport me te akuzuarit A. dhe F. vazhdon me shqyrtimin e dyte për te vazhduar pastaj ne shqyrtim gjyqësor .

Te akuzuarit A. dhe F. ne shqyrtim gjyqësor mbeten ne tersi pranë deklarimeve te tyre ne seancën fillestare mbi pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit-Agron Galani, në fjalën e tij përfundimtare fillimisht bëri përmirësimin e diapozitivit në pikën II të aktakuzës ku është cekë koha e kryerjes së veprës penale ora 21:45 min , nuk duhet të ekzistoj por duhet të jetë ora 22:17 min. Deklaroi, se gjatë shqyrtimit fillestar i akuzuari D. M., e ka bërë pranimin e fajësisë për veprat penale të cilat i vihen në barë sipas aktakuzës, te cilin pranim e ka aprovua gjykata, për çka edhe i propozoi gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor për veprat penale për të cilat është akuzuar, si dhe i njëjti të obligohet në pagimin e shpenzimeve të procedurës penale, një herrit propozon që të bëhet konfiskimi i armës të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës, e po ashtu edhe të akuzuarit A. I. dhe F. K., të shpallen fajtor për veprën penale lëndim i lehtë trupor dhe të dënohen sipas ligjit si dhe të obligohen në pagimin e shpenzimeve procedurale.

I dëmtuari A2.B., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se parashtron kërkesë për kompensim dëmi, për këtë është në procedurë të kompensimit me mbrojtësin e viktimave ku dhe është deklaruar për lartësinë, por për momentin shuma nuk i kujtohet, dhe çdo gjë ia lë në vlerësim gjykatës.

Mbrojtësi i akuzuarit D.M., avokati Gëzim Kollçaku, ne fjalën e tij përfundimtare deklaroi, se i mbrojturi i tij D.M., që nga fillim i procedurës penale – në polici, prokurori dhe shqyrtim fillestar e ka pranuar fajësinë duke shprehur keqardhje dhe pendim të thellë për veprimet e tija për të cilat akuzohet me aktakuzën e prokurorit të shtetit, e që konsideron se këto rrethana trupi gjykues do i merr si rrethana lehtësuese ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore, e gjithashtu i propozoi trupit gjykues që si rrethanë lehtësuese të mirët edhe provokim i bërë nga ana e këtu të dëmtuarit ashtu siç është cekë edhe në dispozitiv të aktakuzës ku thuhet se papritmas me grusht e godet të akuzuarin D., në pjesën e nifullës së djathë e pastaj fillon te largohet , pra, krejt ka filluar nga provokimi i dëmtuarit dhe konsideron se është njëra ndër rrethanat lehtësuese e paraparë si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin me dispozita ligjore, si rrethanë tjetër lehtësuese propozoj të mirët edhe rrethana se i mbrojturi i tij është familjar, mbajtës i vetëm i familjes, është prind i tre fëmijëve të mitur, i gjendjes së dobët ekonomike dhe si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjendjen e tij shëndetësore të rëndë pasi që i njëjti me muaj të tërë është nën mbikëqyrjen e mjekëve të spitalit të Burgut të Dubraves, nga se lëngon nga sëmundje kardiake dhe dokumentacioni për këtë gjendet në shkresat e lëndës, të gjitha këto rrethana konsideron se përbëjnë rrethanën posaçërisht lehtësuese dhe i propozon gjykatës që ndaj të njëjtit të shqiptoj një dënim nën minimumin e paraparë ligjor, e sa i përket rrethanës renduese i propozon gjykatës që mos të mirët dënushmëria e mëparshme e të mbrojturit te tij nga se për herën e fundit ka bërë veprë penale në vitin 2014, dhe është në vuajtje të dënimit tani dhe është shumë i sigurt se mos të kishte pas një provokim ditën kritike nga i dëmtuari me siguri nuk do të kishte qenë këtu nuk do të ndodhte fare një veprë.

I akuzuari D. M., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi, se përkrah në tërësi fjalën e mbrojtësit, shton se i vie keq për rastin e ndodhur.

I akuzuari A. I., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi, se i vie keq çka ka ndodhur dhe mbetet pranë asaj që ka deklaruar paraprakisht dhe se e ndien veten te pafajshëm, qëllimi që ka vrapuar pas te dëmtuarit ishte që mos të vie deri te një e keqe më e madhe.

I akuzuari F. K., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi, se mbetet pranë asaj që ka deklaruar paraprakisht se nuk e ndien veten fajtor se në kohën e ngjarjes nuk ka qenë në vendin e ngjarjes.

Siç u cek me lart gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt. 21.01.2019 dhe pas leximit të aktakuzës , Gjykata është bindur së i akuzuari D.M. e ka kuptuar aktakuzën dhe duke vepruar në kuptim të nenit 246 par.4 të KPPRK-se, të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë. Me këtë rast, Gjykata e ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 248 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPPK-se, kështu që i akuzuari D. ka deklaruar së është plotësisht i vetëdijshëm për rëndësinë e pranimit të fajësisë dhe shton së ky deklarim paraqet shprehje të vullnetit të tij të lirë, pasi ai është kryes i veprave penale të cilën nuk ka si ta mohoj, në tërësi e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar sipas aktakuzës dhe se pranimi i tij është i mbështetur edhe në provat të cilat i janë ofruar gjykatës me aktakuzë, të njëjtit i vie keq për rastin, se është pënduar duke i kërkuar falje publike te dëmtuarit.

Pas deklarimit të akuzuarit për pranimin e fajësisë, Gjykata kërkoi nga Prokurori i shtetit , mbrojtësi i viktimave, i dëmtuari dhe mbrojtësi i të akuzuarit të japin mendimin e vetë për pranimin e fajësisë.

Në këtë drejtim Prokurori i Shtetit deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit D., nga se pranimin e fajësisë e ka bërë edhe gjatë dhënies së mbrojtjes së tij në prokurori dhe një pranim i tillë ka mbështetje edhe në provat tjera materiale të propozuara në aktakuzë , propozon që pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit të aprovohet,

Mbrojtësi i viktimave në këtë drejtim deklaroi se me që pranimi i fajësisë nga i akuzuari ishte i vullnetshëm propozoi që ky pranim të aprovohet nga gjykata, sa i përket kërkesës për dëmshpërblym do e parashtrajnë në kontest të rregullt civil.

I dëmtuari A2 B. pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari D..

Mbrojtësi i të akuzuarit në këtë drejtim deklaroi, se pas konsultimeve të mjaftuara që i kishte me klientin e tij , pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë vullnetarisht dhe asnjë rrethanë nuk është rrethanë e shtrëngimit apo detyrimit por si akt mbi bazat vullnetare, propozon që gjykata ta aprovojë pranimin e fajësisë nga i akuzuari .

Në vijim, Gjykata duke e shqyrtuar pranimin e fajësisë, nga ana e të akuzuarit D. vlerësoi së pranimi i fajësisë paraqet shprehje të vullnetit të lirë të akuzuarit , pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pranimi i fajit është bërë në mbështetje të fakteve të prezantuara në aktakuzë, në përputhje me kërkesat e nenit 248 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPPR të Kosovës.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, është vërtetuar gjendja faktike si në pikën I të diapozitivit të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike, siç është përshkruar në pikën I të diapozitivit të këtij aktgjykimi, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të akuzuarit D.M., qëndrojnë të gjitha elementet e veprave penale ,te vrasjes në tentative nga neni

178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, si dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë, Gjykata ka gjetur se te i akuzuari D. ka ekzistuar dashja që veprat penale ti kryen në mënyrë të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, pasi që i njëjti ka qenë i vetëdijshëm për veprat e kryera dhe i ka dëshiruar kryerjen e tyre.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit , kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit për te akuzuarin D., Gjykata i ka vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 par.1 te KPRK-së. Kështu si rrethane renduese gjykata pati parasysh se i njëjti me pare ka qene i dënuar për vepër penale te njëjtë , te cilin dënim është duke vuajtur ne Burgun e Dubraves , kurse si rrethana lehtësuese, Gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti është penduar për veprat penale , duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen një gjë e tillë më nuk do të përsëritet, kërkim faljen publike te dëmtuarit, gjendjen e vështirë ekonomike, i martuar baba i tre fëmijëve te mitur , nivelin e ulët të arsimimit dhe sjelljen korrekte gjatë procedurës penale, te cilat gjithashtu kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana favorizuese. Si rrethana veçanërisht lehtësuese gjykata pati parasysh se i njëjti paraprakisht ka qene i provokuar nga i dëmtuari A2 të cilën rrethanë nuk e ka mohuar as i dëmtuari A2 se e ka goditur me grusht në pjesën e nofullës së djathtë, si dhe faktin se i akuzuari qysh ne fillim te hetimeve e edhe ne shqyrtimin e seancës fillestare e ka pranuar fajësinë për veprën penale, gjë qe dëshmoi gatishmëri për bashkëpunim me organin e akuzës dhe me gjykatën dhe kjo sipas vlerësimit të gjykatës paraqet pendim të singertë të tij dhe fillim të procesit të rehabilitimit të tij, ne prezencën e këtyre rrethanave lehtësuese dhe rënduese, ne mbështetje te nenit 75 par.1 pika 1.3 të KPRK-se, te akuzuarin e ka gjykuar si ne diapozitiv te këtij aktgjykimi me te cilën do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Duke i vlerësuar kështu te gjitha rrethanat e parashikuara me nenin 73 par.1 të KPRK-së, Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen por ai do të ndikoj edhe si preventivë gjenerale për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPRK-së .

Vendimi që të akuzuarit në dënimin e shqiptuar i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim u mur në kuptim të nenit 83 të KPK-së.

Vendimi për konfiskimin dhe asgjësimin e revoles , të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është marr ne kuptim te nenit 62 par.1. pika 1.7 te KPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 450 par 2 pika 2.6 te KPRK-së, Gjykata ka vendosur që të akuzuarin ta obligoj në pagimin e paushallit gjyqësorë dhe shpenzimeve procedurale.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë komfor nenit 39 par.3 nën par. 3.2 të Ligjit nr. 05/L-036 .

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt civil u murr ne kuptim të nenit 463 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 të KPPRK-së, është vendosur si nën pikën I të diapozitivit të këtij aktgjykimi.

I akuzuari A. I. ne mbrojtjen e tij ne te gjitha fazat e procedurës penale, ka deklaruar se ditën kritike, ora e sakte nuk i kujtohet diku rreth orës 8.20 minuta, me qe afër shtëpisë se tij e ka kafiterin “T...”, ka shkuar për ta shikuar lojën e futbollit, brenda ne lokal është ulur vetëm ne një tavolinë , dy tavolina larg tij kanë qenë të ulur A2i, L. dhe E. U., ky i fundit është axha i një shokut tij, me te ka fole ia ka qit një cigare, kurse të tjerët i njeh si figura. Kur ka filluar loja kanë ardhur SH. H. dhe D. M. , ata nuk kanë qenë të interesuar me shiku lojën dhe janë ulur jashtë lokalit. F. K. e njeh dhe nuk ka qenë atë natë në lokal ekzistonte mundësia me qenë por ky nuk e ka vërejtë.

Sa i kujtohet atë natë D.i ka shkuar me mbushë telefonin në shank, ka dal jashtë, dhe kur ka dashtë me shku në shtëpi është kthyer me e marr telefonin dhe për me dal jashtë lokalit është dashtë të kaloj kah tavolina e tij ku ne një tavolinë tjetër aty afër ishte i ulur A2i, i cili ishte i kthyer me shpinë kah tavolina e tij i fokusuar në TV dhe kishte një kasketë në kokë, pra ishte duke përcjellë ndeshjen. Derisa D.i ishte duke dal prej lokalit A2i është ngritur në këmbë e ka goditur në nofull diku ndër sy dhe D.i, ka qenë gadi duke u rrezuar, mirëpo është mbështetur në shank dhe nuk është rrëzuar në tokë, është ba tollovi dhe për momentin e kapi një panik. A2i është larguar me vrap nga lokali, ky i ka shkuar pas, nuk e din se pse ka vrapuar pas tij, por mendon se i ka ardhur në afekt, gjatë vrapimit ka qenë i pari, pas tij ka shku D.i, ku ai ka filluar me shtëne, ky është ndal dhe D.i e ka kaluar dhe ka dal përpara, i ka dëgjuar dy të shtëna, nuk ka vërejtur se a ka vrapuar edhe dikush tjetër pas tij. Duke vrapuar e ka kaluar D.i, në një kthesë A2i ka marr n’thu afër dyqanit “F...”, dhe është rrezuar dhe D.i ja ka hi në kokë edhe dy herë me qykë të alltisë , është munduar me i nda e ka ngre D.in, në at momente kanë dal edhe disa familjarë të familjeve – lagjes aty afër. Nuk ka vërejtur se D.i përveç me allti ta ketë goditur edhe me diçka tjetër. Nuk ka vërejtur askënd të njohshëm aty prezent kur A2i është rrezuar, se çka ka ndodhur më tutje me A2in nuk e din. I vie keq çka ka ndodhur për dy palët.

E vërtetë është se A2i, L. dhe E., atë natë në lokalë kanë qenë duke pi verë. Atë nate ka pas vetëm çantën në krah, në dorë nuk ka pas asnjë mjet. Shton se është e vërtetë se i njeh të dy palët A2in dhe D.in këtë te fundit e njeh si shok të dhëndrit te tij i ka ndodhur me ndjetë me te por nuk ka shoqëri, dhe se nuk kishte asnjë arsye me u përfshi në konflikt dhe se në lokalin ku ka ndodhur ngjarja më shumë ka ndjetë me A2in se me D.in, qëllimi i tij qe ka vrapuar pas te dëmtuarit A2 dhe te akuzuarit D. ka qene mos me ndodh diçka me keq . Sipas dëshmitarit, D.i fillimisht nuk e ka ditur kush e ka goditur, por këtë e ka kuptu kur është rrëzuar A2i ia ka hjekur kaçkëtën dhe e ka vërejtur se kush është. Atë nate te dëmtuarit A2 nuk i ka vërejtur asgjë ne dorë por ka kuptuar nga i akuzuari D., se A2i ka pas atë natë thikë kur është rrezuar i ka ra edhe thika dhe D.i ia ka marr thikën. Ka qene ne njohuri se A2i, ka pas mosmarrëveshje para 17 viteve, jo me D.in por me S. N., edhe ai shok i D.it, nuk ka njohuri nëse dikush natën kritike e ka ftuar D.in qe te vie ne lokal i sigurt është se personalisht nuk e ka ftuar D.in.

I akuzuari F. K. ne mbrojtjen e tij ne te gjitha fazat e procedurës penale ka deklaruar se natën kritike, nuk e mohon se ka qenë në lokalin “T...”, por, se ka qenë më herët diku rreth orës 22.00, ka hy ne lokal, lokali ka qene i mbushur me mysafir, ka qëndrua 2-3 minuta në shank deri sa e ka pire një limonade dhe me motoçikletën e tij ka shkuar ne qytet me qe ne lokal ishte shume tollovi dhe zhurme. Diku pas 40 minutave,, me qe shtëpia e tij ishte jo larg lokalit ne fjale pikërisht afër dyqanit “F...” te pompa “XH...” , ne te kthyer ne shtëpi afër lokalit “T...”,

ka pare disa drita vezulluese te policisë. Me qene se punëtorët ishin në pompë i ka pyetur se çka ka ndodhur, i kanë treguar se ka pas përleshje dhe qe janë dëgjuar do krisma. Kur ai është kthyer ne shtëpi para lokalit „F..”, nuk ka vërejte asgjë, e ka thirr A. I.n në telefon me marr vesh çka ka ndodhur, i njëjti i ka treguar se çka ka ndodhur, dhe i tha se D.it i rra një djalë, dhe D.i e rrehu atë djalin dhe asgjë tjetër. A. I.n e njeh se e ka të lagjes, D.in e njeh si person dhe me te nuk është shoqëruar. A2 B., e ka njohur si emër pas rastit të ndodhur kur është ftuar në polici me dhënë deklaratë, me pare nuk e ka njohur as si figurë e as si emër. Atë nate te akuzuarin D. e ka vërejtur qe ka qenë i ulur ne një tavoline jashtë lokalit me SH. H. ku me këtë te fundit janë nga i njëjti fshat. Me tutje shton se nuk ka njohuri se pse i dëmtuari deklaroi se gjeja atë natë e ka goditur , ekziston mundësia qe e ka ngatërruar me dikë. Sipas dëshmitarit ne kamerat e vendit te ngjarjes te cilat ia ka treguar policia ka vërejtur 3-4 persona duke vrapua, sa i kujtohet e kane njoftuar hetuesit se është D.i dhe A.i, e pësonin tjetër nuk e ka njohur, nuk e ka njohur as pësonin i cili ka vrapuar i pari (verifikimi i gjykatës i dëmtuari).

Kjo gjykate gjate shqyrtimit gjyqësor administroi këto prova, mbrojtjen e te akuzuarit A. I. dhe te akuzuarit F.K. , dëgjoji te dëmtuarin dëshmitarin A2 B. , dëshmitarët, E.U., SH.H. dhe L.L., ne cilësi te dëshmitarëve janë dëgjuar Dr SH.S. dhe Dr. N.L. këta dy te fundit te dëgjuar sipas propozimit te prokurorit ne shqyrtim gjyqësor, lexohet raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe shikohet ne foto dokumentacionin me nr. te rastit ... te dt. 11.09.2018, raporti mbi ekzaminimin e dëmtuarit A2 B., nga Spitali i Përgjithshëm Pejë, nën nr.rendor protokolli 18797 dt.11.09.2018 dhe raporti i Dr N. L. i datës së njëjtë, raporti policit hetues dt.21.09.2018 nën nr...., mbi tërheqjen e incizimeve nga kamera te sigurisë me nr. të njëjtë të rastit dt.11.09.2018, shikohet ne CD-në, e incizimeve nga kamera te sigurisë në vendin e ngjarjes, lexohen deklarata e dëshmitarëve L.L., e dhëne në polici dhe prokurori, dëshmitarit SH.H., dëshmitarit E.U., të dëmtuarit A2 B., si dhe mbrojtjet e pandehurve A.I. dhe F.K. të dhëna në polici dhe prokurori.

Gjykata pas administrimit të provave në seancën e shqyrtimit gjyqësor të njëjtat i vlerësoi një nga një dhe në lidhmëni reciproke me provat tjera ne kuptim te nenit 361 te KPPRK-se , ne raport me te akuzuarit A.I. dhe F.K. dhe pas vlerësimit te tyre , është vendosur si nen piken II te diapozeve te këtij aktgjykimi për arsyt si ne vijim.

Nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe foto dokumentacioni me nr. te rastit ... te dt. 11.09.2018, gjykata ka vërtetuar se ngjarja ka ndodhur ne rrugën „Nënë Tereza,, ne Pejë , e cila është rruge publike dhe te shpie ne Spitalin Regjional të Pejës , fillimisht ngjarja kishte filluar ne kafiterinë “T...” , për te vazhduar ne ambient te hapur rrugës për spital ne anën e djathte ishte lokali „E...”, te „B...”, dhe përfunduar para dyqanit te „F..”, kishte ndreqim nate jo i dukshëm, mot i mire pa te reshura , te gjitha këto lokale –rruga qe u cek ishin në largësi rreth 100 m. Gjate shikimit te vendit te ngjarjes afër vijës se mesit te rrugës është gjetur një gëzhjojë me mbishkrim te stampuar ... e cila është evidentuar me numër 1 dhe është tërhequr si dëshmi.

Nga raporti i oficerit policor hetuesit N. G. ne numër te rastit te njëjtë te dt. 21.09.2019, gjykata ka vërtetuar se me dt. 11.09.2018 ne Rr. ,,, ka ndodhur një tentim vrasje ku viktime e rastit ishte A2 B. kurse si te dyshuar D. M. , A. I. dhe F. K., gjate hetimeve te rastit ne afërsi te vendit te ngjarjes kane vërejtur kamerat qe ishin te vendosura ne shtëpinë private te G.SH., dhe nga ana e policisë me urdhër te prokurorit kamerat ne fjale janë tërhequr.

Nga video incizimi i kamerave te siguruara, afër vendit te ngjarjes ne shtëpinë e G. SH dhe pas shikimit te tyre nga trupi gjykues ne shqyrtim gjyqësor gjykata ka vërtetuar se ne orën 22.18.04 shihet viktima duke ikur me vrap ne drejtim te Spitalit ndërsa pas tij shihen tre te akuzuarit

duke vrapuar pas viktimës , ne ora 22.18.22 shihet i akuzuari D. qe gjate ndjekjes shtinë me revole dy here ne drejtim te viktimës dhe vazhdojnë me ndjekje te viktimës, për te cilat veprime te tija i akuzuari D. ka pranuar veprat penale. Gjykata gjate shikimit te CD te kamerave ku është edhe vendi i ngjarjes ku A2i këtu viktima është rrezuar para dyqanit te ,, “F..”,, e siç pretendon prokurori se përveç te akuzuarit D. i cili e godet dy here ne koke viktimën me qyke te revoles, te njëjtin dy here me grushta e kane goditur edhe te akuzuarit A. dhe F. ne pjese te ndryshme te trupit, gjykata pas shikimit te këtyre kamerave nga kjo prove nuk ka mund te vërtetoi se te akuzuarit A. dhe F. ta kenë goditur te dëmtuarin me grushta ne pjese te ndryshme te trupit, për vet faktin se kamerat e siguruar nuk kishin mbulueshmëri edhe ne vendin te dyqani ,,”F..”,,.

Nga raportet mjekësore te Dr. SH. S. dhe Dr N. L. te dyja te dt. 11.09.2018 është konstatuar se plaga ne koke është plage e shkaktuar me predhe me hyrje dalje transkutane pra nëpër lëkurë ne pjesën e sipërme te kokës ne anën e djathte, pa dëmtime dhe nuk ka pas rrezik për shëndetin e tij, gjithashtu pas kokës ne zverk ka pas edhe një plage tjetër dhe ka mundur me u shkaktu me mjete mbrehtëse.

Ne raportet mjekësore është konstatua edhe një gërvishtje ne bërrylin e dorës, e për te cilin lëndim i dëmtuari A2 deklaroi se kjo gërvishtje i është shkaktuar gjatë rrëzimit në tokë afër dyqanit ,, “F..”,,.

Nga shikimi i foto dokumentacionit për te dëmtuarin gjykata ka vërtetuar se ne kokën e te dëmtuarit shihen dy plage, njëra ne pjesën e sipërme te kokës ne anën e djathte kurse tjetra jo shume larg te pares mbas kokës ne zverk, e qe përputhen me plagët qe janë përshkruar ne raportet mjekësore te cekura me larte, për shkaktimin e te cilave plagëve i akuzuari D. ka pranuar veprimet e tija gjithashtu këto lëndime te shkaktuara dhe me mjetet me te cilat janë shkaktuar e te përshkruara me larte janë ne përputhshmëri te plote edhe me deponimin e te dëmtuarit kur deklaroi se i akuzuari D. ka shtënë ne te me revole dhe e ka godite me qyke te revoles ne koke.

I dëmtuari - dëshmitari A2 B.j ne raport me te akuzuarit A. dhe F. K., ka deklaruar se natën kritike brenda ne kafiterine “T...”, ulur ne një tavoline ka qene me L. L.n dhe E. U., brenda ne lokal ka qene i akuzuari A. I. me SH. I. kurse ne një tavoline jashtë lokalit kane qene te ulur dëshmitari SH. H. i akuzuari F. dhe D. ky i fundit ka ardh me vone, në ndërkohë ka ardhur deri te përleshja mes dëmtuarit dhe të akuzuarit D., dhe për momentin kur e ka pa se D.i po vinte afër tavolinës e ka goditur me grusht në një pjesë të kokës, pastaj ka dal prej lokalit dhe ka filluar me ikë duke vrapuar në drejtim të spitalit, menjëherë pas tij ka dal prej lokalit A. I., pastaj 10 metra pasi është larguar prej lokalit deri sa nuk ishte duke vrapuar por duke ecur me hapa të shpejtë e ka dëgjuar një të shtënë fillimisht me armë, por nuk kishte njohuri se kush ka gjuajte e pas këtij momenti ka filluar të ikë në mënyrë zik zake, pas 20-30 metra D.it i ka thënë mos gjuaj, pastaj ka pas ndjesinë e një të nxehti në kokë dhe pas 10-15 metra, ka pa se maica i ishte përgjakur, e ka humbur hapin dhe ka ra në tokë në afërsi të dyqanit ,,”F..”,, pastaj A.i, F.i dhe D.i kanë filluar me goditë, D.it ja ka vërejt armën me të cilën me qyke të armës e ka goditur , diku në pjesën pasme të kokës, kurse këta dy personat tjerë e kanë goditur me grushta në pjesë të ndryshme të trupit, për A.in dhe F.in nuk ka njohuri se sa here e kane goditur, gjithashtu nuk i kujtohet a e kane godit shume a pak dhe a ka ndi dhimbje. Arsyja pse te akuzuarin F. nuk e ka përmend ne polici ka qene gjendja e rende shëndetësore. Të akuzuarin A. e njeh para 5-6 viteve, si mysafir ne lokalin ,,T.....”, dhe raportet me te kane qene normale, kurse te akuzuarin F. e ka njohur si figurë dhe nuk kishte pasur kurrfarë raporte me të. Shton se ngjarja ka ndodhur rreth orës 22.00 dhe ne vendin e ngjarje ka pas pak ndriçim. Ne raport me te

akuzuarin A. sqarohet se ne lokal nuk i ka pa arme por e ka vërejte duke e shti dorën në çantë, por kur kane dal jashtë ka dëgjua një te shtënë por fillimisht nuk kishte njohuri se kush ka shtënë. Sa i përket lëndimeve qe i ka pësuar natën kritike i dëmtuari deklaroi se në spital kanë konstatuar se ne pjesën anësore të djathtë kishte një goditje nga predha dhe në pjesën e pasme të kokës kishte goditje nga një mjet i fortë dhe sigurisht ka qenë nga qyka e pistoletës e i shkaktuar nga D.i, gjithashtu ka pas lëndime edhe në bërryl të dorës i cili i është shkaktuar pas rrëzimit të tij afër dyqanit „F.“, .Natën kritike ne koke ka pas kaqkete por nuk ka njohuri se ku i ka mbetur. Gjatë dhënies së deklaratës së tij në polici dhe pasi që ia kanë lëshuar kamerat nga vendi i ngjarjes , përveç D.it dhe A.i që kanë vrapuar pas tij e ka identifikuar personin F. K.. Në polici në zyrë e kanë sjellë të akuzuarin F. K., dhe të njëjtin e kanë dërgua me identifikim, e ka identifikuar F.in por me emër nuk e ka njohur, me atë rast gjatë identifikimit në polici F.i ka qenë vetëm dhe i ulur dhe nuk ka pas asnjë person tjetër vetëm hetuesit, kurse lidhur me rrethanën se fillimisht a e ka shikuar kamerën e pastaj e ke bërë identifikimin , nuk ka njohuri , ekziston mundësia pasi që e ka pa kamerën , por prapë mbetet pranë asaj se nuk e din saktë.

Dëshmitari E.U. ne shqyrtim gjyqësor ka deklaruar, se A2i dhe L. rreth orës 8.30 min e kanë ftu me shku ne kafiterinë “T...”, me shiqu lojën e futbollit, afër tavolinës tyre ka qene i ulur A.i ,por me kënd ka qene ulur nuk i kujtohet, por se i kujtohet se ia ka qit një cigare. Nuk ka vërejte se çka ka ndodhe ne lokal nga se ka qene i koncentruar ne TV, por vetëm ka dëgjuar një zhurmë dhe te gjithë kanë dal para lokalit dhe pronari i lokalit Ramizi i ka thënë se ma prishi shoku yt ndejën duke menduar në A2in, duke shpjeguar se i njëjti i ka ra grusht atij personi. Deri sa ishte para lokalit e ka vërejtur A2in afër ordinancës Q... duke vrapuar ne drejtim te spitalit , nuk e ka vërejtur dike tjetër duke vrapuar pas A2it se ka qene terr. I kujtohet se F.i ka qenë në lokal a ka qenë brenda apo jashtë nuk e din por kur kane hy ne lokal ka qenë së bashku me A.in. Pas rastit A2in e ka takuar në spital, lidhur me rastin i ka treguar se ka pas probleme më parë me D.in dhe atë para 15 viteve, se kush e ka gjuajte me armë nuk i ka treguar por vetëm tregoi se e kanë plagosur. Se a ka qenë i goditur prej dikujt tjetër nuk e ka përmendur A2i, gjithashtu nuk ka përmend emra nëse dikush ka vrapuar pas tij. Me A2in pasi ka dal prej spitalit ka pas rast me qëndru me te por për rastin nuk kane biseduar. .Ka dëgjuar se çka është fole se pas tij kanë vrapuar dy person por se ky personalisht nuk i ka pa.

Dëshmitari L. L., ne deponimin e tij ne shqyrtim gjyqësor ka deklaruar, se ka dhënë deklaratë në prokurori dhe polici dhe mbetet në tërësi pranë atyre deklaratave, është e vërtete se natën kritike ka qenë në kafiterinë “T...”, se bashku me A2 B. dhe dëshmitarin E. U. për ta shikuar lojën e futbollit. Atë natë në lokal ka pas plot mysafir. A. I.n dhe F. K., i njeh si figura nga lagja, por nuk i kujtohet se a kanë qenë atë natë në lokal kanë muajt me qene por nuk i kujtohet, gjithashtu ne lokal atë natë nuk ka vërejtur kurrfarë përleshje, por në një moment pas krijimit të një tollovie e ka vërejtur A2in duke ikur me vrap nga lokali , dhe pasi me E.n kane dal nga lokali e ka vërejtur A2in duke vrapuar në drejtim të spitalit. Nuk ka vërejtur askënd duke vapuar pas A2it meqë ishte terr dhe nuk ka pas ndriçim dhe ka qene nën ndikim të alkoolit. Ka dëgjuar krisma të armës mirëpo nuk ka mundur të përcaktoj sa krisma ka pas. Pasi ka kuptuar se çka i ka ndodhur A2it, pas 10-15 minutave me E.n kane shkuar me vizitua A2in në Spital, A2i ishte në gjendje shumë të rëndë dhe nuk ka fol, ishte i qetë .Ekziston mundësia qe D.i, A.i dhe F.i te kenë qene ulur jashtë lokalit, por brenda lokalit nuk i ka vërejtur.

Dëshmitari SH.H., ne deponimin e tij ne shqyrtim gjyqësor ka deklaruar, se natën kritike ne kafiterinë “T...” ka shkuar me D.in, janë ulur ne një tavoline jashtë ku ishte i ulur SH. I. i cili në ndërkohë është ngritur. Ka vërejtur se brenda ne lokal ka qene A.i por me kënd nuk e ka vërejt. F. K. e njeh dhe natën kritike te njëjtin nuk e ka vërejtur ne lokal , por e ka pa vetëm me motor

duke kaluar rrugës dhe duke shkuar në drejtim të shtëpisë dhe atë në drejtim të spitalit, i ka përshëndetur me dorë por nuk është ndaluar.

Sipas dëshmitarit deri sa ishin duke qëndruar në lokal në një moment ka dëgjuar zhurmë ka menduar se ka fituar dikush në bastore dhe atë A. i cili kur F. bënë zhurmë, në atë moment ka qenë i kthyer me fytyrë kah rruga dhe kur është ngritur në këmbë e ka pa një person të cilin nuk e ka njohur, por tani e di se ishte i dëmtuari A2, dhe e ka pa duke vrapuar në drejtim të spitalit, pas tij i ka vrenjtur dy persona duke vrapuar por nuk ka mund ti vërej nga pas se kush kane qene ata persona , nga se pronari i lokalit ka bërtitur duke thënë se pse po bini kësi persona në lokal dhe ky pastaj ka humbur vëmendjen.

Dr.SH. S., lidhur me raportin e përpiluar me nr. protokollit ... për te dëmtuarin A2 , e cila natën kritike kishte qene kujdestare ne Emergjencën e Spitalit Regjional ne Peje, ka deklaruar se ne raport si zakonisht ka konstatuar anamnezën dhe është cekur se i njëjti është lënduar me armë zjarri nga një person tjetër në kokë dhe ka ardhë në emergjencë me gjakderdhje nga koka. Fillimisht i bëjnë disa ekzaminime dhe së pari kranio gramini dhe se ky është fotografimi i kockave të kokës, nëse ka ndonjë frakturë, aty nuk janë shfaqë ndryshime por për me konstatua më thellë e bëjmë një CT tomografi e kompjuterizuar, dhe ajo ka dal pa veçori patologjike-donë me thënë se nuk ka pas frakturë e as shënja patologjike. Gjate ekzaminimit objektiv ka vërejtur një lëndim në kok pjesa parietale dhe temporale në anën e djathtë të kokës është bere përpunimi i plagës donë me thënë qepja, pastrimi dhe është trajtuar edhe me terapi medikamentoze intravenoze, e tërë kjo është çka është trajtuar dhe është ndërmarrë në emergjencë. Pas ofrimit të ndihmës shëndetësore pacienti është lëshuar për trajtim të mëtejme në shtëpi me mbrojtje anti tetanike, antibiotik dhe analgetik.

Kane qenë dy plagë, plaga e pare siç u cek me larte, kurse plaga e dytë ka qene në pjesën parietale (pjesa e pasme e kokës zverku), plaga e pare ne anën e djathte ka mundur të shkaktohet me mjete mprehëse që nënkupton edhe nga predha, gjersa plaga në pjesën e pasme të kokës ka mundur me u shkaktoja me mjete mbrehtëse, te cilin konstatim e ka bere Dr N. L., gjithashtu ne raportin e këtij mjeku është konstatua edhe një gërvishtje ne bërryl dhe për këto më saktësisht mundet mu deklarua ai vetë. Shton se nga ky raport nuk shifet se i dëmtuari të ketë pas ndonjë lëndim tjetër përveç atyre të shënuar më larte .

Dr. N. L. ne shqyrtim gjyqësor lidhur me raportin e Dr SH. S. ka deklaruar se fillimisht nga mjeku kujdestar i emergjencës i është marre anamneza dhe është konstatuar se është lënduar me armë zjarri në kokë dhe në emergjencë është pranuar me gjakderdhje në kokë.

Si kirurg për trajtim të mëtejme ka kërkuar qe te behet CT-ja e kokës e cila ka rezultuar me lëndime në kokë, dhe është konstatuar se në kokë kanë qenë dy plagë të përfaqëta në pjesën parietale anash – anësore, dhe është bërë përpunim i plagës qepja diagnoza përfundimtare është konstatuar plagë me armë zjarri në bazë të anamnezës e marr nga mjeku paraprak i emergjencës dhe dy plagëve në pjesën anësore të kokës të cilat i kanë pas veçorit hyrëse dhe njëra dalëse, dhe që ka përngja në diagnozën e prejjudikuar nga mjeku i emergjencës, pa pranim të ndonjë projektili vetëm si plagë tej shkuese (transkutane), kurse plaga tjetër ne pjesën e epërme te kokës ka mundësi te jete shkaktoja me mjete mbrehtëse kjo është e tëra, është edhe një plagë në pjesën e bërrylit ku është konstatuar gërvishtje. Dhe këto lëndime janë lëndime të lehta trupore.

Faktet e pakontestueshme e te mbështetura ne prova të administruara në shqyrtim gjyqësor te cilave gjykata ua ka fale besimin janë si në vijim .

Nuk është kontestuese se natën kritike ne kafiterinë “T...”, përveç te akuzuarit D., kane qene edhe te akuzuarit A. dhe F..

Nuk është kontestuese se për një moment i dëmtuari A2 deri sa ishte brenda kafiterisë “T...”, e godet të akuzuarin D., në pjesën e nfullës së djathtë dhe me vrap fillon të largohet nga lokali, pas tij vrapojnë, i akuzuari D. , A. dhe F.

Nuk është kontestuese se i akuzuari D., ne ndjekje e sipër te dëmtuarit A2 , me armen e tij shtënë dy herë në drejtim të A2it, me ç’rast me një predhë e godet në pjesën e sipërme të kokës me hyrje – dalje transkutane, në për lëkurën në anenë djathtë të kokës.

Nuk është kontestuese qe i dëmtuari A2 duke vrapuar rrëzohet para dyqanit ““F..””, atij i afrohet i akuzuari D., i cili e godet edhe dy herë me qykë të pistoletës në pjesën e epërme të kokës.

Prokurori i shtetit, me aktakuzën e tij, te akuzuarit A. dhe F. i akuzon se me dt.11.09.2019, rreth orës 22.17 minuta, në rrugën “...”, në Pejë, mu para dyqanit “F..”, e pasi që i dëmtuari A2 B.j, rrëzohet, të akuzuarit A. dhe F., e godasin të njëjtin dy herë me grushta në pjesë të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar lëndim të lehtë trupor, pa cekur fare se ne cilat pjese te trupit viktima është goditur nga te akuzuarit A. dhe F. respektivisht ne cilat pjese te trupit te dëmtuarit i janë shkaktuar lëndimet e lehta.

Kontestuese për gjykatën gjere ne përfundim te shqyrtimit gjyqësor, qe ishte edhe objekt shqyrtimi, është se te akuzuarit A. dhe F. a e goditen dy here me grushta te dëmtuarin A2 kur ky i fundit ishte rrezuar para dyqanit ,,”F..”,, dhe a i shkaktuan lëndime te lehta te dëmtuarit A2.

Me qe prokuroria ne këtë drejtim gjykatës nuk i kishte ofruar prova te mbështetshme dhe te besueshme, me përjashtim te deponimit te dëmtuarit A2 i cili pos tjerash deklaroi se për një moment e ka humbur hapin dhe ka ra në tokë në afërsi të dyqanit ,,”F..”,, pastaj A.i, F.i dhe D.i kanë filluar me goditë, D.it ja ka vërejt armën me të cilën me qykë të armës e ka goditur , diku në pjesën pasme të kokës, (për gjykatën nuk është kontestuese nga se i akuzuari D. e ka pranuar fajësinë për veprimet e veta) , kurse këta dy personat tjerë A.i dhe F.i e kanë goditur me grushta në pjesë të ndryshme të trupit, por nuk ka njohuri se sa here e kane goditur, gjithashtu nuk i kujtohet a e kane godit shume a pak dhe a ka ndi dhimbje, qe sipas gjykatës kjo pjese e deponimit te dëmtuarit A2 për gjykatën nuk është bindëse një herrit është ne kundërshtim me raportet mjekësore dhe deponimet e mjekeve lidhur me raportet e tyre ne shqyrtim gjyqësor ku nga raportet e mjekut kujdestar dhe kirurgut dhe deponimit te tyre rezulton, se i dëmtuari ka pas dy plage njëra ne pjesën anësore që ka mundur të shkaktohet me mjete mprehëse që nënkupton edhe nga predha, dhe pjesa tjetër pas koke e shkaktuar me mjete mbrehtëse (qe për gjykatën nuk ishte kontestuese për te cilat plage i akuzuari D. e ka pranuar fajësinë për këto veprime te tij) , sa i përket plagës gërvishtje ne bërryl sipas te dëmtuarit kjo gërvishtje i është shkaktuar nga rrënja ne toke para dyqanit ,, “F..” ,,,Me qenë se ne raportet e mjekeve dhe ekzaminimit objektiv te dëmtuarit nga mjekët dhe deponimi i tyre ne seancë, nuk janë vërejt dhe nuk janë konstatuar plage tjera ne trupin e te dëmtuarit përveç atyre të cekura më lartë, atë here parashtrohet pyetja se cilat lëndime te lehta ia shkaktuan te akuzuarit A. dhe F. te dëmtuarit A2, lëndime këto për te cilat pretendon prokurori e te cilat nuk i ka cek fare nen piken II dispozitivit ta aktakuzës se ku e goditen dy te akuzuarit dhe ne cilat pjese te trupit ia shkaktuan lëndimet e lehta te dëmtuarit A2.

Deponimi i te dëmtuarit ne këtë drejtim nuk ka mbështetje as ne video incizimet e siguruara ne vendin e ngjarjes nga ana e prokurorit ku ky video incizim nuk kishte mbulueshmëri te dyqani ,, “F..”,, dhe nuk shifet fare vendi kur i dëmtuari është rrezuar ne afërsi te këtij dyqani , gjithashtu nuk kane mbështetje as ne provat tjera materiale te elaboruara me larte e as ne dëshmitë e dëshmitarëve E. U. , L. L. dhe SH. H., nga se te njëjtit ne deponimet e tyre kane deklaruar vetëm për rastin e ndodhur fillimisht ne kafiterine ,,T....,, , dhe me qe nga ky lokal gjere ne vendin tjetër te ngjarjes ku i dëmtuari A2 është rrezuar afër dyqanit ,, “F..” ,, largësia ishte rreth 100 metra , asnjeri nuk kishin njohuri lidhur me ngjarjen qe është zhvilluar ne afërsi te dyqanit,, “F..”,, se kush e ka plagos e as kush e ka goditur dhe kush ia ka shkaktuar lëndimet, edhe pse dëshmitari E. she L. menjëherë pas ngjarjes kane shkuar me vizitua te dëmtuarin ne spital te njëjtit deklarojnë se i dëmtuari A2 nuk ju ka treguar se kush e ka gjuajte me armë por vetëm tregoi se e kanë plagosur, nuk ka tregu se nga kush ka qene i goditu , gjithashtu nuk ka përmend emra nëse dikush ka vrapuar pas tij, por i dëmtuari vetëm kishte thënë se me plagosen . Andaj gjykata kësaj pjese te deponimit te dëmtuarit ne raport me dy te akuzuarit A. dhe F. nuk ia fali besimin .

Andaj nga këto të lartë cekurat nuk mund të përcaktohet e as të konkretizohet përgjegjësia penale e të akuzuarve A. dhe F..

Nga arsyet e theksuara më lartë e ne mungese te provave gjykata te akuzuarit A. dhe F. i liroi nga akuza.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil u murr në mbështetje të nenit 463 të KPPRK-së.

Vendimi që te akuzuarit u liruan nga obligimi i shpenzimeve gjyqësore , të cilat shpenzime bien në barrë mjeteve buxhetore të gjykatës u murr në mbështetje të nenit 454 par.1 të KPPRK-së

Andaj nga sa u tha më lartë u vendos si nën piken II te dispozitivit të këtij aktgjykimi komfor nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së

Duke u bazuar ne nenin 368 te KPPK-se, Gjykata palët ne procedure i njoftoi me paralajmërimet qe shoqërojnë aktgjykimin.

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,
DKR P nr.101/18 dt.17.05.2019, i përpiluar me dt.14.06.2019.

Sekretarja Juridike
Shpresa Kërnya

Kryetarja e Trupit Gjyqësor
Lumturije Muhaxheri

UDHEZIM JURIDIK

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës se Apelit ne Prishtinë, e përmes kësaj gjykate

Numri i lëndës: 2018:054781
Datë: 25.06.2019
Numri i dokumentit: 00375762